

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 14 PRILL 2022

Është shumë e qetë kjo seancë e sotme, në fakt, dhe nuk e kuptoj përse gjithë kjo qetësi e madhe, ndërkohë që kanë ndodhur çështje të mëdha këtë javë, të cilat e prekin të gjithë këtë parlament për shumë e shumë arsye. Po e filloj nga e para dhe dua të tregohem i drejtpërdrejtë dhe i sqartë me këdo. Po, ju e prekët raportin e DASH-it. Ju po e studioni, po e lexoni, po thelloheni në të, pavarësisht se i pari juaj tha se është copy-paste me atë të vitit të kaluar. Do të thotë se paskeni pasur kohë një vit e ndoshta më tepër vite për ta lexuar, për ta studiuar dhe për të nxjerrë konkluzione, ndërkohë që konkluzionet e raportit amerikan, pra të DASH-it, tregojnë gjëra shumë të mëdha, pas të cilave secili në këtë parlament do të duhet të mbajë përgjegjësi të madhe.

Zgjedhjet janë të delegjituara. Në zgjedhje janë përdorur patronazhistët, në zgjedhje është përdorur krimi i organizuar, në zgjedhje është përdorur pushteti dhe rezultati nuk është ai që do të duhej t'i përgjigjej realitetit, pra vullnetit të shqiptarëve. Kjo, në fakt, është një nga konkluzionet më të mëdha. Edhe një koleg juaji, nga Partia Socialiste, i cili tashmë u kujtua për të vazhduar me hetimin përmes komisionit hetimor, në fakt, ka qenë ai, bashkë me ju, të cilët i dhatë fund komisionit hetimor, për të arritur në këto konkluzione që më në fund amerikanët i thanë. E pra kjo është gjëja për të cilën do të duhet të reflektoni, të studioni, të nxirrni konkluzionet e me radhë, por kjo është vetëm gjysma e asaj se çfarë ka ndodhur kësaj jave. Ka ndodhur edhe diçka tjetër, ka ndodhur një dizenjim nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe i Thesarit për një personazh politik tuajin. E këtu ka që në mëngjes e sot nuk flet askush nga ju, nuk flet askush për të mbajtur një qëndrim.

Ndaj unë dua t'u them dy kolegëve deputetë: është çështja juaj qëndrimi që duhet të mbani. Mund ta mbani, është çështje personale, por ndoshta ju të dy, në fakt, jeni të fundit të cilët do të duhet të mbani përgjegjësi, sepse është personale. Në fakt, përgjegjësinë më të madhe politike do të duhet ta mbajë ai që nuk është këtu. Do të duhet ta mbajë Kryeministri i vendit. Do të duhet ta mbani ju, kolegë. Çfarë qëndrimi mbani ju ndaj vendimeve të Departamentit Amerikan të Shtetit dhe të Thesarit për përcaktimin e personave politikë non-grata? Cili është qëndrimi juaj? Cili do të jetë standardi moral dhe politik, që ju duhet të vendosni përtej emrave individualë, si një standard i politikës për të sotmen dhe për të ardhmen? Çfarë mendoni ju për atë se çfarë është vendosur si justifikim nga e gjithë ajo ndërmarrje e madhe që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë vendosur? A keni ju një opinion? Është shpata e Demokleut politike që qëndron mbi kokën tuaj.

Nuk mund ta mbani kokën ulur dhe të lexoni celularin. Do të duhet ta gjeni kurajën për të hequr sikletin e kujt do e, mbi të gjitha, për të hequr sikletin e shqiptarëve! Këtë, pra, do të duhet të bëni ju. Do të prisni sa të vijë ai nga Amerika a ku është? Po, priteni edhe atë, por, në fakt, autonominë tuaj njerëzore do të duhet ta nxirrni këtu e të thoni, para se t'ju japë urdhër! E di se cilat do të jenë spërdredhjet që do të bëni. E diskutova dje në Konferencën e Kryetarëve me atë që do të flasë pas meje dhe, si gjithmonë, tha: "Përgjegjësia është individuale". Jo, jo, nuk është përgjegjësi individuale, është përgjegjësi publike e të gjithëve këtu, sepse bëhet fjalë për atë se çfarë fati i qeverisjes së shqiptarëve.

E pra, i lexoni ju raportet e Departamentit të Shtetit, i studioni ato? Jo vetëm ka rrëzuar zgjedhjet e 25 prillit, jo vetëm ka vendosur gishtin në plagë, jo vetëm i kanë dhënë të drejtë opozitës, kanë folur ata tashmë, por kanë treguar edhe diçka tjetër në terma numerikë, se nuk jeni maxhorancë dhe nuk keni të drejtë të qeverisni shqiptarët! Këtë qëndrim do të duhet të mbani ju sot. Është në nderin tuaj, është stofi, karakteri, morali i gjithsecilit prej jush! Dilni e flisni këtu tani! Shikojini shqiptarët në sy, mbani qëndrimin tuaj dhe merrni masat tuaja! Thuaji të vijë atij që do të flasë pas meje tani!